

FAKTORËT ME NDIKIM NË PUNËN DHE SHËNDETIN MENDOR TË
MËSIMDHËNËSVE PËRGJATË PANDEMISË COVID-19

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

SHKURTË BAJGORA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2021

Faktorët me Ndikim në Punën dhe Shëndetin Mendor të Mësimdhënësve përgjatë Pandemisë

COVID-19

Shkurtë Bajgora

Mentori: Zamira Hyseni – Duraku, Prof. Asoc. Dr.

Ky studim ka për qëllim të hulumtojë ndërlidhjen mes distresit psikologjik dhe ankthit të mësimdhënësve të arsimit fillor, klasët 1 deri 5, gjatë pandemisë, me mësimin virtual dhe me mësimin fizik. Kjo periudhë aktuale nuk është e hulumtuar mjaftueshëm, gjë që e bën edhe më të nevojshëm studimin. Përveç kësaj, studimi do provojë të shoh për ndikimin e variablave të tjera si qëndrimet për zhvillim profesional (siç janë: avancimi i njohurive për përdorimin e teknologjisë, ndjekja e trajnimeve etj.). Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 120 persona të cilët janë edukatorë të kopshteve dhe edukimit parafillor, si dhe mësimdhënës të shkollave fillore, të klasave nga një deri në pesë. Prej mësimdhënësve është kërkuar të plotësohen pyetësorët në tërësi.

Studimi do përpiqet që t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore të cilat janë: cila është ndërlidhja mes distresit psikologjik dhe ankthit me konsumimin e mësimdhënësve; dhe cila është ndërlidhja mes distresit psikologjik dhe ankthit me motivimin e mësimdhënësve? Hipotezat për këtë studim të cilat priten të mbështeten janë që sa më i lartë ankthi aq më i lartë distresi psikologjik tek mësimdhënësit; sa më i ulët ankthi aq më i lartë motivimi tek mësimdhënësit; sa më i lartë distresi psikologjik aq më i ulët motivimi tek mësimdhënësit; sa më i lartë distresi psikologjik aq më i lartë konsumimi tek mësimdhënësit, sa më i lartë ankthi aq më i lartë konsumimi tek mësimdhënësit.

Hulumtimet me mësimdhënës tregojnë që vendi ku realizohet studimi luan rol të rëndësishëm. Në rastin e Kosovës, mjetet teknologjike dhe kushtet ekonomike për ti siguruar ato e kanë zgjeruar ende më shumë hapësirën e edukimit në këtë periudhë, gjë që ka shkaktuar që hulumtimi poashtu të ketë fokus në mësimin virtual dhe pasojat që janë shkaktuar.

Sipas analizës korrelacionale rezultatet tregojnë se ka një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të konsumimit të mësimdhënësve me distresin psikologjik, $r(120) = .61, p < .01$. Kjo tregon që sa më shumë që mësimdhënësit përjetojnë konsumim nga puna, aq më i lartë është distresi psikologjik. Poashtu, rezultatet tregojnë se ka një ndërlidhje signifikante negative mes konsumimit dhe ankthit, $r(120) = -.21, p < .05$. Kjo tregon që marrëdhënia mes konsumimit dhe ankthit është negative, e cila mund të jetë për shkak që ankthi është forcues pozitiv dhe shtyes për punë në disa raste. Përveç tyre, shohim që motivimi për vlerësim të nxënësve ka ndërlidhje signifikante negative me ankthin, $r(120) = -.22, p < .05$. Kjo ndërlidhje negative na tregon që mësimdhënësit kanë përjetuar ankth gjatë pandemisë sepse mësimdhënësit që kanë pasur më shumë motivim për vlerësim të nxënësve kanë pasur më pak ankth, në krahasim me mësimdhënësit e tjerë për të cilët vlerësimi i nxënësve ka qenë i pacaktuar dhe i papërcjellur në mënyrë kualitative nga mësimdhënësit, gjë që ju ka shkaktuar rënie të motivimit dhe ngritje të ankthit.

Përveç analizave statistikore për të dhënat kuantitative, pjesë e pyetësorëve ishin edhe pyetjet e hapura apo të dhëna kualitative, të cilat mbështesin të dhënat e raportuara paraprakisht. Gjatë këtij viti, mësimdhënësit raportuan shqetësime të ndryshme për mirëqenien e tyre psikologjike. Ndër temat e diskutuara është konsumimi profesional dhe motivimi për punë gjatë pandemisë COVID-19, për shkak të distresit psikologjik dhe ankthit të shkaktuar nga mësimi virtual dhe ndryshimi i metodave të mësimdhënies.

“Mësimi në distance ka veshitresuar punen dhe ka shtuar lodhjen.”

“Ka ndikuar pak, sepse është rritur numri i oreve brenda nje dite, por kemi edhe ngarkese psikologjike, sepse orari mesimor është i shkurtuar.”

“Ka qenë shumë stresuese puna në këtë vit shkollor!”

“Punë dhe angazhim shtesë në arritjen e rezultateve që i kemi përcaktuar për nxënësit. Ballafaqimi me shumë sfida të reja në komunikimin me nxënës dhe prindër.”

“Pandemia COVID-19 ka ndikuar në konsumimin tim profesional. Per shkak te kesaj pandemie, realizimi i mesimit dhe aktivitetet me nxenes kane marre nje kah krejtesisht te ndryshem nga ajo se si jemi mesuar deri me tani dhe kjo sigurisht ka ndikuar ne konsumimin tim profesional.”

Që nga korriku i vitit 2020, 98.6% e nxënësve në të gjithë botën u prekën nga pandemia, duke përfaqësuar 1.725 miliardë fëmijë dhe të rinj, nga arsimi parafillor në arsimin e lartë, në 200 vende (United Nations, 2020). Prandaj, bërja e mundshme dhe e disponueshme e mësimit nga shkollimi në shtëpi ka qenë nevoja e më e madhe në atë kohë. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në arsim do të ketë pasoja të mëdha. Një kuptim më i mirë i përvojave të mësimitdhënësve dhe nxënësve në të gjithë vendin është thelbësor në informimin e asaj që mbështet dhe rregullimet janë të nevojshme tani dhe në të ardhmen.

Roli i psikologëve shkollorë është zgjeruar në nevojë dhe rëndësi ndërsa studentët dhe mësimitdhënësit luftojnë me jetë në mënyrë drastike të ndryshuar për shkak të pandemisë së vazhdueshme COVID-19, izolimit, çështjeve të varësisë familjare, një rritje të varfërisë dhe përshtatjes me mësimin hybrid. Psikologët e shkollës janë të përgatitur të ndërhyjnë në nivelet individuale dhe të sistemit, dhe të zhvillojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë programe për të promovuar mjedise pozitive të të mësuarit për fëmijë dhe të rinj nga prejardhje të ndryshme, dhe për të siguruar qasje të barabartë në shërbime efektive arsimore dhe psikologjike që promovojnë zhvillimin e shëndetit (APA, 2020).

Sipas rezultateve të treguara, për të rregulluar klimën e hapësirës punuese për stafin e shkollës duhet të njihet puna e mësimitdhënësve sepse ata kanë nevojë për reagime pozitive dhe

inkurajim nga anëtarët e stafit. Tu mësohet menaxhim i stresit dhe mekanizma të përballimit, të kujdesen për shenjat apo treguesit e vetëvlerësimit të ulët mes kolegëve, të ofrohen mentorime shtesë për mësimdhënësit e sapo punësuar. Të krijohen dhe implementohen programe që promovojnë shëndetin mendor, si të mësimdhënësve ashtu edhe të nxënësve, si dhe të ndahen përgjegjësitë e punës në mënyrë të barabartë mes stafit.

Rritja e ofrimit të mbështetjes dhe motivimit të mësimdhënësve për t'u bërë pjesë e ndryshimit janë po ashtu faktorë të tjerë organizativë të cilët është vërtetuar të kenë ndikim dhe sugjerohet të konsiderohen nga drejtorët e shkollave përgjatë implementimit të ndryshimeve (Rayan & Ackerman, 2005). Rikujtimi i mësimdhënësve për përparësitë e ndryshimit, dhe ngritja e zhvillimit të tyre profesional, shkathtësive dhe njohurive të nevojshme për ndryshim, janë faktorë të tjerë të cilët mund ta lehtësojnë ndryshimin. Poashtu, nevoja për avancimin e mëtutjeshëm të mësimin në distancë, dhe ngritja e ndërveprimit në mes të mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve, avancimi i mënyrës së dhënies së instruksioneve për realizimin e detyrave nga nxënësit, dhe sqarimi i metodave të vlerësimit. Për të kontribuar tutje janë profesionistët e shëndetit mendor – psikologët e shkollave - të cilët mund të jenë kontribues në mbështetjen emocionale, ngritjen e motivimit, përmirësimin e qëndrimeve ndaj ndryshimeve dhe mbështetjen në avancimin e njohurive e shkathtësive të qëndrueshme nga edukimi nga secila palë përfituese e sistemit të edukimit. Psikologët shkollorë janë anëtarë të kualifikuar në mënyrë unike të ekipeve shkollore që mbështesin aftësinë e studentëve për të mësuar dhe aftësinë e mësuesve për të dhënë mësim. Ata aplikojnë ekspertizë në shëndetin mendor, të mësuarit dhe sjelljen, për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë të kenë sukses akademik, shoqëror, sjelljes dhe emocionalisht. Psikologët e shkollës bëjnë partneritet me familjet, mësuesit, administratorët e shkollës dhe profesionistë të tjerë për të krijuar ambiente të sigurta, të shëndetshme dhe mbështetëse të të mësuarit që forcojnë lidhjet midis

shtëpisë, shkollës dhe komunitetit. Duke pasur këtë prapavijë, kontribuojnë në krijimin e hapësirës të sigurtë dhe pozitive për zhvillim profesional, motivim dhe eliminim apo parandalim të konsumimit në punë, ankthit, dhe/apo distresit psikologjik.